



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.23.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
SKENDERAJT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga, Ajtene Llapashtica, Udhëheqës Ekipi dhe Ylber Sadiku, Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Zukë Zuka.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	26
5 Qeverisja e mirë.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	30
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve për dy vitet paraprake.....	32
Shtojca III: Letër konfirmimi	39

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës Skënderaj për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 21/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e stafit të komunës, përgjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i Çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se informatat e shpalosura në Pasqyrat Financiare Vjetore në lidhje me pasuritë nuk janë të sakta.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Pasqyrat financiare - Theksimi i çështjes pasqyron dobësitë në kontrolle për të konfirmuar shpalosjet në pasqyrat financiare të pasurive financiare dhe jo financiare.



Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së pasqyrave financiare për vitin 2018 përfshinë një rishikim përfundimtar të menaxhmentit përgjegjës, dhe deklarata për pasqyrat financiare të nënshkruhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih kapitullin 2.1).

Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në disa fusha, dobësi evidente janë vërejtur në disa sisteme të rëndësishme financiare, duke përfshirë, shpenzimet, pasuritë dhe obligimet.



Kryetari duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 2 - 16).

Rekomandimet e viteve paraprake nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e komunës.



Kryetari, duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i zbatimit të rekomandimeve të viteve paraprake adresohen në mënyrë aktive (shih çështjen 17).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial kanë shënuar progres, por jo të mjaftueshëm.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial (shih çështjen 18 dhe 19).

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e pasqyrave financiare vjetore. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu, merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Skenderajt për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Nëntë pagesa¹ me vlerë 207,625€ dhe dy pagesa në vlerë prej 13,513€ nuk janë paraqitur në regjistrin e pasurisë në SIMFK;
- Regjistri i pasurisë në SIMFK është mbivlerësuar me pasuritë e regjistruara të cilat ishin të keq planifikuara/buxhetuara për vlerën 32,495€, gjithashtu edhe regjistri i pasurive nën 1,000€ është nënvlerësuar për 1,595€ për blerje të reja të vitit 2017; dhe
- Regjistri i pasurive është nënvlerësuar si pasojë e zhvlerësimit të llogaritur (12,419€) për 11 projekte të papërfunduara të cilat ishin regjistruar gabimisht si pasuri në përdorim përderisa ishin investim në vijim.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Skenderajt është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

¹ Pagesat lidhur me: "Hartimi i projekteve" dhe "Rrënimi i objekteve" e që do të duhej të regjistroheshin dhe t'ju bashkëngjiten projekteve kryesore.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve; dhe
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë, raportet operative (të performancës).

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Drejtori për Buxhet dhe Financa, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Kryetari, duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për ta konfirmuar menaxhimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë, përfshirë edhe shpalosjen e drejtë të tyre në PFV.

Po ashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Skenderajt kishte shpenzuar 98% të buxhetit final për vitin 2017, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në inkasimin e tyre dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe.

Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar ekzekutimin e pagesave në mënyrë jo të rregullt, dhe vonesave për përfundimin e projekteve. Me tutje, komuna duhet të ndër marrë veprime për të përmirësuar menaxhimin dhe raportimin e pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	11,932,216	12,285,771	12,065,482	11,640,027	11,235,296
Granti i Qeverisë -Buxheti	10,744,341	10,703,964	10,575,442	10,539,790	10,548,574
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	184,938	168,199	276,513	250,467
Të hyrat vetjake ⁴	1,187,875	1,393,441	1,320,642	816,824	419,732
Donacionet e brendshme	-	501	-	6,900	8,449
Donacionet e jashtme	-	2,927	1,199	-	8,074

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 353,555€. Ky ndryshim është rezultat i të hyrave këtij viti dhe të bartura nga viti paraprak, nga donacionet dhe zvogëlimi nga granti qeveritar.

Niveli i realizimit të buxhetit në komunë ishte në nivel të kënaqshëm. Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar rreth 98% të buxhetit final ngjashëm me vitin paraprak.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,932,216	12,285,771	12,065,482	11,640,027	11,235,296
Pagat dhe Mëditjet	7,372,119	7,332,629	7,267,204	7,322,830	7,244,135
Mallrat dhe Shërbimet	983,432	1,108,422	1,042,725	964,549	870,692
Shërbimet komunale	200,440	205,496	187,782	233,088	210,757
Subvencionet dhe Transferet	180,642	202,138	197,944	252,965	203,787
Investimet Kapitale	3,195,583	3,437,086	3,369,827	2,866,595	2,705,925

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje fillimisht ishte rritur me të hyrat vetanake të bartura me vlerë 887€, ndërsa sipas vendimit qeveritar kishte zvogëlim në vlerë 40,377€. Përshtatjet e tilla kanë ndikuar që të ketë reduktim buxheti në këtë kategori për 39,490€;
- Te mallrat dhe shërbimet, buxheti final ishte rritur nga të hyrat vetanake për 124,990€, ndërsa për shërbimet komunale 5,056€;
- Buxheti final te subvencionet në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur nga të hyrat vetanake për 21,496€; dhe
- Buxheti i investimeve kapitale ishte ndikuar nga rritjet me të hyrat vetanake prej 241,503€.

Në bazë të vendimeve gjyqësore nga thesari janë ekzekutuar gjithsejtë 11 pagesa në vlerë prej 74,480€, dhe një pagesë është ekzekutuar sipas nenit 39.2 me vlerë 129,325€. Pagesat ishin ekzekutuar në mungesë të mjeteve dhe vonesave në pagesa nga ana e komunës.

Procesi i realizimit të buxhetit ishte në nivel të kënaqshëm. Megjithëse vetëm në tremujorin e parë shpenzimet e realizuara ishin 41%, si shkak ishin pagesat e realizuara për projektet e vonuara/realizuara në vitet e mëhershme.

Çështja 2 - Keq-klasifikimi i shpenzimeve

E gjetura Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 43,681€ për projektin “Furnizimi me kontejner për mbeturina” ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale.

Shpenzimet për subvencione në vlerë 9,950€ janë realizuar gabimisht nga buxheti i investimeve kapitale, ndërsa shpenzimet e bëra për investime kapitale në vlerë 13,513€ ishin realizuar gabimisht nga mallrat dhe shërbimet.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i ndarjeve të mjeteve buxhetore sipas nevojave, ka ndikuar në keq klasifikimin e shpenzimeve. Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës, si dhe në mos realizimin e të gjitha projekteve kapitale të synuara për arritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime të bëhen konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin në vlerë 1,413,200€, këto të hyra komuna i realizon nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe për komunën e Skenderajt të hyrat që i inkasojnë institucionet tjera janë: nga gjobat në trafik 42,893€, dhe dënimet e gjykatës 17,844€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,187,875	1,187,875	1,413,200	994,851	702,249
Totali	1,187,875	1,187,875	1,413,200	994,851	702,249

Komuna kishte realizuar performancë të mirë në realizim të të hyrave, përkatësisht kishte tejkaluar planifikimet për 18%. Arsyeja e këtij tejkalimi ka të bëjë me inkasimin e pagesës së koncesionit në vlerë prej 624,165€.

Çështja 3 – Mos verifikimi i 1/3-tës të pronave nën menaxhim të komunës

- E gjetura** Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 03/2011 neni 13 - verifikimi në teren i pronave, zyra Komunale e tatimit në pronë është e obliguar që çdo vit të bëjë verifikimin në teren të 1/3-tës së pronave të regjistruara. Sipas regjistrave të Zyrës Komunale për tatimin në pronë janë gjithsej 10,914 prona të regjistruara në Komunën e Skenderajt, prej tyre për vitin 2017 janë verifikuar vetëm 1,396 prona, ose 13%.
- Rreziku** Mos verifikimi i 1/3-tës të pronave mund të rezultojë me informata të paplota të pronës së tatueshme aktuale, pasi nuk përfshihen ndryshimet në prona si dhe mund të ketë humbje potenciale financiare nga inkasimi më i ulët.
- Rekomandimi 3** Kryetari, duhet t'i analizojë pengesat në zbatimin e kësaj kërkesë dhe të identifikojë mënyra për adresimin e rekomandimit në këtë fushë. Kryetari duhet të siguroj mekanizma efektiv për verifikimin e kuotës së përcaktuar prej 1/3-tës së pronave për tatimin në pronë siç kërkohet me udhëzimin administrativ.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Komuna e Skenderajt për vitin 2017 për paga dhe mëditje kishte buxhet në vlerë prej 7,332,629€, derisa ka shpenzuar 7,267,204€ apo 99% të buxhetit final.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i burimeve njerëzore ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve të organizatës për të siguruar funksionimin e sistemit në përputhje me politikat e administratës komunale dhe të kuvendit komunal, të cilat zbatohen në gjithë organizatën. Menaxhimi i BNj përfshinë: Hartimin dhe rishikimin e strukturës organizative, kategorizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, kontrollin e kostove buxhetore të personelit, si dhe kontrollin e procesit të rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të personelit, duke përfshirë këtu edhe matjen e efektivitetit të personelit përmes vlerësimit të performancës së kryerjes së detyrave.

Çështja 4 – Dobësi në menaxhimin e procedurave të rekrutimit

- E gjetura** Komuna e Skenderajt nuk ka arritë të sigurojë kontrolle adekuate në menaxhimin e procedurave të rekrutimit. Ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim:
- Në konkursin “Mësimdhënës për mësim klasor/zëvendësim” vërejtëm se nuk ishin ndjekur procedurat e mbajtjes së testit me shkrim. Përzgjedhja e kandidatit ishte bërë vetëm në bazë të intervistës;
 - Për konkursin “Mësimdhënës për lëndën edukatë fizike” ishte organizuar vetëm testi me shkrim e jo edhe intervista, për më tepër nuk ishte përzgjedhë kandidati me vlerësimin më të lartë; dhe
 - Për pozitën “Mësimdhënës të gjuhës angleze në shkollën në Krasaliq”, rezultojë se nuk kishte pasur konkurs për atë pozitë. Kandidati⁵ ishte përzgjedhur nga konkursi i mbajtur për pozitën e njëjtë në shkollën Polac.
- Rreziku** Shmangia nga procedurat e rekrutimit ka për rrezik përzgjedhjen e drejtë dhe meritore të punonjësve duke u bazuar në konkurrencë të mirëfilltë.
- Rekomandimi 4** Kryetari, duhet të sigurojë proces transparent dhe konkurrues për të gjithë aplikantët duke ndjekur procedurat e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës sipas UA për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, me qëllim të përzgjedhjes së duhur të stafit.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 1,313,918€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,230,507€ rreth 94%. Këto kryesisht përfshijnë shpenzimet komunale, shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera, etj.

Çështja 5 - Kontratat me marrëveshje për shërbime të veçanta

- E gjetura** Komuna gjatë vitit 2017 ka angazhuar tetë punonjës/staf me marrëveshje për shërbime të veçanta (MShV). Angazhimi i tre prej tyre ishte bërë pa aplikuar procedura të konkursit publik por vetëm me kërkesë të Drejtorive përkatëse komunale. Në dy raste angazhimi i tyre ishte për tetë muaj, duke tejkalluar afatet e përcaktuara ligjore prej gjashtë muajve. Për më tepër, shumica e të punësuarave në këtë formë janë vendosur në pozita ku duhet të jenë punëtor me pozita të rregullta të punës.

⁵ Kandidati i ranguar i dytë në listë është përzgjedhë për pozitën në shkollën Krasaliq.

Rreziku Angazhimi i stafit me MShV për pozita të rregullta pune mund të rezultojë në jo efikasitet/efektivitet operacional në arritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi 5 Kryetari, duhet të siguroj se punonjësit me MShV të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se janë marrë në konsideratë me rastin e planifikimit buxhetor, të trajtohen si të nevojshme dhe të diskutohen me MF.

Çështja 6 – Dobësi në procedurat e prokurimit

E gjetura Te kontratat⁶ “Furnizim me material elektrik dhe vegla pune për shkollat dhe komunën” si dhe te “Shërbimet e mirëmbajtjes teknike të institucioneve komunale dhe arsimore”, kemi evidentuar se në dosjet e tenderit nuk ishin përcaktuar sasi të indikative lidhur me furnizimet/shërbimet që do të realizoheshin. Gjithashtu, nuk ishte bërë përcaktimi i çmimeve sipas rëndësisë së artikujve-shërbimeve për tu siguruar se ishte përzgjedhur Operatori Ekonomik (OE) me çmimin më të lirë⁷.

Rreziku Shmangia apo mospërfillja e procedurave të prokurimit gjatë përzgjedhjes së ofertave rrezikon që të përzgjidhet oferta më e mirë për komunën, njëherit mund të shfaqen probleme edhe te realizimi i kontratave/ekzekutimi i pagesave.

Rekomandimi 6 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë përgjatë procedurave të prokurimit për të siguruar se ato zhvillohen komfor kërkesave ligjore dhe ofrojnë vlerë të shtuar për paranë e shpenzuar. Për më tepër, si në rastin e cekur, kriteret mbi përcaktimin e çmimeve sipas rëndësisë së artikujve duhet të jenë vendosur, në mënyrë që të ketë bazë përcaktuese për përzgjedhjen e OE.

⁶ Kontrata e parë e furnizimit nuk kishte paraparë montimin, funksionalizimin e pajisjeve të furnizuara, andaj është realizuar edhe kontrata e dytë për këtë qëllim

⁷ Kërkesë e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (neni 28.12; neni 56.10 dhe 56.11).

Çështja 7 – Mangësitë në menaxhimin dhe ekzekutimin e pagesave

E gjetura Te kontrata “Sigurimi fizik i objekteve komunale” kemi evidentuar se pagesa prej 6,133€ për shërbimet e realizuara për muajin nëntor ishte realizuar pas skadimit të kontratës. Data e skadimit të kontratës ishte 05.11.2017 mirëpo për shkak të vonesave në lidhjen e kontratës së re, komuna kishte vazhduar të pranonte shërbimet deri më 27.02.2018. Vonesat nga ana e njësive kërkuese dhe ankesave në procedurat e prokurimit ishin arsytet për mos lidhjen e kontratës së re me kohë.

Për më tepër pagesat ishin realizuar në dy kompani, njëra si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më të cilin ishte lidhur kontrata), ndërsa tjetra si biznes individual. Gjysma e pagesave⁸ të kryera përgjatë realizimit të kontratës ishin bërë në kodin dhe llogarinë bankare të operatorit të regjistruar si biznes individual⁹. Urdhër blerjet ishin lëshuar në kodin e vjetër të furnitorit ndonëse operatori faturimin e kishte bërë sipas kushteve kontraktuale.

Tek pagesa në vlerë 4,388€ për kontratën “Furnizimi me dru për ngrohje” kemi evidentuar se pranimi i mallrave ishte bërë vetëm nga një person (dëshmi fletë-dërgesa). Komisioni pranues në fund kishte hartuar një raport bazuar në fletë dërgesat individuale.

Rreziku Mos respektimi i procedurave/kërkesave ligjore mund të rezultojnë me pagesa të parregullta dhe me mungesë të buxhetit për realizimin e projekteve të parapara. Pagesat e realizuara në llogari tjetër bankare përveç atyre të kontraktuara tregojnë dobësitë e kontrolleve të brendshme në komunë dhe mund të rezultojnë në anashkalimin e obligimeve tatimore nga ana e operatorit ekonomik. Pranimi i mallrave nga një person është në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe rrezikon që mallrat nuk pranohen në sasinë dhe cilësinë e kontraktuar.

Rekomandimi 7 Kryetari, duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet e rasteve të identifikuara dhe të sigurojë se njësitë kërkuese paraqesin me kohë kërkesa për llojin dhe nevojën e shërbimeve, po ashtu, të shtohen kontrollet gjatë ekzekutimit të pagesave, në mënyrë që, realizimi i pagesave të bëhet sipas kushteve të përcaktuara. Të gjitha mallrat dhe shërbimet duhet të pranohen sipas kushteve kontraktuale dhe nga komisionet përkatëse.

⁸ Pagesat 83,454€ prej 169,318€ sa ishin realizuar në total.

⁹ Në vitin 2009, komuna kishte kontratë me biznesin individual.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 202,138€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 197,944€ ose rreth 98%. Subvencionet ndahen për entitete publike dhe jopublike.

Çështja 8 – Sfidat në menaxhimin e Subvencioneve

E gjetura

Dobësi që janë identifikuar te dhënia e subvencioneve janë se:

- Në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për përfitimin e subvencioneve, në një rast kemi vërejtur se përfituesi nuk kishte përmbushur kriterin “jo më pak se një hektar”, pasi kishte ofruar 0.8 hektar tokë. Për subvencionimin e dhënë nuk ka ndonjë raport apo plan monitorues. Sipas dokumentacionit i tërë procesi ka përfunduar me blerjen dhe shpërndarjen e fidaneve; dhe
- Te subvencionimi për klubet sportive, në dy raste kemi vërejtur se nga ana e klubeve nuk ishte parashtruar kërkesë për subvencionim, siç kërkohet me rregulloren e komunës për shpërndarjen e subvencioneve¹⁰. Kërkesa për marrjen e vendimit për subvencionim ishte parashtruar nga drejtori i drejtorisë së kulturës te kryetari i komunës.

Rreziku

Vlerësimi jo i drejtë nga ana e komisionit vlerësues, redukton objektivitetin dhe transparencën gjatë ndarjes së subvencioneve, ndërsa mungesa e monitorimit të plotë dhe të dëshmuar shton rrezikun për mos arritjen e objektivave të përcaktuara të subvencionit të dhënë.

Rekomandimi 8

Kryetari, duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet në procesin e ndarjes së subvencioneve, dhe se përfituesit i plotësojnë kriteret në bazë të cilave është lejuar subvencioni bazuar në rregullore. Gjithashtu duhet siguruar monitorimi i procesit të subvencionimit, deri sa të arrihet siguria se mbështetja e dhënë ka arritur qëllimin e subvencionimit.

¹⁰ Neni 4 i rregullores së subvencioneve sipas së cilës organizatat jo fitimprurëse duhet dorëzuar kërkesat e kompletuara me dokumentacion mbështetës për subvencionim.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,437,086€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 3,369,827€ apo 98%. Investimet kanë të bëjnë kryesisht me rregullim të infrastrukturës, ndërtim të shkollave, shpronësime, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

Çështja 9 – Dobësitë në planifikim dhe lidhjen e kontratave

E gjetura Sipas marrëveshjes për bashkëfinancim të projektit “Rregullimi i kanalizimit fekal në Skënderaj”, MMPH do të financonte projektin me 10,000€ ndërsa pjesa tjetër do të financohej nga komuna. Mirëpo, komuna kishte lidhur kontratë me operatorin ekonomik (74,130€) ku përcaktohej që obligimi i komunës është 10,000€ ndërsa pjesa tjetër i takon MMPH-së. Kontrata ishte lidhur në mungesë të zotimit të mjeteve buxhetore pasi për këtë projekt në PIP për vitin 2017 nuk ishin ndarë mjete buxhetore.

Gjithashtu në tri projekte të testuara¹¹ kemi vërejtur se mjetet e parashikuara në PIP ishin 397,000€, ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara për këto projekte ishte 1,573,236€.

Rreziku Kontratat e lidhura në kundërshtim me marrëveshjet, përtej planifikimeve buxhetore dhe në mungesë të mjeteve, përcillen me implikime buxhetore për komunën e cila sfidohet me obligime të shumta pa mbështetje financiare me ndikim në vonesa të realizimit të projekteve.

Rekomandimi 9 Kryetari, duhet të sigurojë se kontratat përpilohen në përputhje të plotë me marrëveshjet e bëra me palët e ndërlidhura me qëllim të evitimit të implikimeve financiare që shkaktohen më tej gjatë realizimit të tyre. Kryetari po ashtu duhet të sigurojë zotimin e mjeteve për projekte para lidhjes së kontratave.

Çështja 10 - Vonesat në realizimin e projekteve

E gjetura Në shtatë pagesa të testuara me vlerë totale 206,516€, që kishin të bënin me katër projekte, kishte vonesa të konsiderueshme në realizimin e tyre. Projektet do të duhej të përfundonin kryesisht në vitin 2015. Arsytet e vonesave ishin planifikimi i dobët i punëve, mungesa e buxhetit dhe vështirësitë e hasura gjatë kryerjes së punëve në teren.

¹¹ Projektet: “Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Qirez-Prelloc-Baks-Krasaliq-Kozhicë-Krasmirofc parashikimi në PIP 220,000€”, kontrata me vlerë 1,085,000€; “Ndërtimi i shkollës Makërma” parashikimi në PIP 142,000€, kontrata me vlerë 418,736€; dhe “Vendosja e dy ashensorëve në objektin e QKMF” parashikimi në PIP 35,000€, kontrata me vlerë 69,500€.

Rreziku Vonesat në përfundimin e projekteve dëmtojnë cilësinë e punimeve, ndikojnë në mos arritjen e objektivave, si dhe do të shfaqen mungesa buxhetore për projektet e vitit për shkak të ngarkesave për t'i paguar obligimet paraprahe.

Rekomandimi 10 Kryetari, duhet të sigurojë një shqyrtim detal të arsyeve që kanë shkaktuar vonesat në realizimin e këtyre projekteve dhe të ndërmerr masat e nevojshme në mënyrë që ato të përfundohen brenda afateve të arsyeshme kohore duke shmangur bartjen e tyre në periudhat e ardhshme.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 11 - Lidhja e kontratave me zotime të pamjaftueshme

E gjetura Në shtatë raste kemi evidentuar se vlerat e zotimeve ishin më të ulëta se kontratat:

- “Furnizim me material elektrik dhe vegla pune për shkollat dhe komunën” vlera e kontratës 110,000€, zotimet e mjeteve 1,148€;
- “Shërbimet e mirëmbajtjes teknike të institucioneve komunale dhe arsimore” vlera e kontratës 120,000€, zotimet e mjeteve 1,141€;
- “Furnizim me derivate të naftës” vlera e kontratës 130,600€, zotimet e mjeteve 2,010€;
- “Furnizimi me tepiha, perde dhe mallra tjera për komunë” vlera e kontratës 58,725€, zotimi i mjeteve 926€;
- “Furnizimi me fidanë të mollës dhe kumbullës për fermerë në komunën e Skenderajt” vlera e kontratës 58,085€, zotimi i mjeteve 5,000€;
- “Rregullimi i kanalizimit fekal në qytet” vlera e kontratës 74,130€, ishte lidhur në mungesë të zotimit të mjeteve buxhetore¹²; dhe
- “Ndërtimi i Shkollës në Makërmal” vlera e kontratës 418,736€, zotimet e mjeteve 22,000€.

¹² Për këtë projekt (44809) në PIP për vitin 2017 nuk ishin ndarë mjete buxhetore, vlerësime ishin bërë për vitin 2018 (60,000€) dhe për vitin 2019 (100,620€).

Rreziku Nënshkrimi i kontratës në mungesë të zotimit të mjeteve, rrezikon mos përmbushjen e kontratës apo zbatimin e vonshëm të saj dhe në këtë mënyrë mosarritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi 11 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre.

Çështja 12 - Tejkalmi i pagesave të kontratave kornizë

E gjetura Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 2/2015 (KRPP) për kontratat publike kornizë, neni 5.1 përcakton përqindjen e mos përputhjes së lejuar nga kontrata e cila nuk mund të jetë më e lartë apo më e ulët se 30%. Në dy kontrata ne identifikuam se kishte tejkalime mbi normën 30% të vlerës së lejuar:

- Për kontratën publike kornizë “Mirëmbajtja dhe riparimi i rrugëve”, tejkalmi mbi vlerën e lejuar ishte prej 39,982€ apo 21%; dhe
- Për kontratën publike kornizë “Furnizim me material mjekësor dhe medikamente”, tejkalmi mbi vlerën e lejuar ishte prej 29,366€ apo 50%.

Tejkalmi i pagesave ishte si pasojë e mungesës së kontrolleve adekuate në pozitat përkatëse të proceseve rishikuese.

Rreziku Tejkalmi përtej vlerës së lejuar nga kontrata kornizë, rezulton me pagesa të parregullta dhe mungesë të buxhetit për realizimin e projekteve të parapara nga këto mjete.

Rekomandimi 12 Kryetari, duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se para përgatitjes së projekteve bëhen analiza të mjaftueshme lidhur me nevojat për furnizimet/punët e kontraktuara. Në këtë mënyrë do të përmirësohet menaxhimi i kontratave dhe do të shmangen rastet e tejkalimit mbi normën e lejuar +/-30%.

Çështja 13 - Mangësitë në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhimin e kontratave

E gjetura Komuna nuk kishte arritur të vendos kontrolle të duhura përgjatë procesit të ekzekutimit të pagesave, sipas rregullave të MFK:

- Asnjë nga faturat e pranuar/paguara nuk është e protokolluar, pasi që komuna nuk ka libër protokollin për evidentimin e faturave të pranuar;
- Për të gjitha pagesat e testuara, të cilat janë ekzekutuar përmes modulit të blerjeve, urdhër blerjet janë bërë pas pranimit të faturës; dhe

- Te të gjitha pagesat e testuara, planet për menaxhimin e kontratave hartoheshin rregullisht, mirëpo mungonte monitorimi i rregullt i tyre dhe plotësimi me informata komfor ecurisë së realizimit të kontratave. Në tri¹³ raste drejtorët e drejtorive ishin emëruar menaxher të kontratave, përderisa ishin edhe autorizues të pagesave, dukuri kjo në kundërshtim me kërkesat ligjore për ndarjen e detyrave.

Rreziku Mungesa e protokollimit të faturave rritë rrezikun e humbjes si dhe mos evidentimin e tyre si obligime. Mos azhurnimi i planit për menaxhimin e kontratave pamundëson pasqyrimin e gjendjes reale të realizimit të kontratës, ndërsa autorizimi i pagesave nga menaxherët e kontratave paraqet konflikt në ndarjen e detyrave.

Rekomandimi 13 Kryetari, duhet të siguroj funksionimin e mekanizmave të kontrollit ku të gjitha faturat evidentohen, protokolohen dhe paguhen brenda afateve të përcaktuara ligjore. Po ashtu, procedimi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPF-në, dhe me rregullat financiare.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të 2017 ishte 153,897,584€, ndërsa vlera e pasurisë jo kapitale ishte 762,206€. Stoqet në fund vit ishin 15,882€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim.

Çështja 14 - Dobësi në menaxhimin, evidentimin dhe raportimin e pasurisë

E gjetura Komuna e Skenderajt nuk ka arritë të sigurojë kontrolle adekuate në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë. Në kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Për evidentimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale (nën 1,000€) dhe stoqeve komuna nuk përdorë sistemin e-pasuria. Për raportimin e tyre në PFV janë përdorë të dhënat të cilat menaxhohen në regjistra të excel-it, dhe si të tilla nuk japin siguri lidhur me plotësinë dhe saktësinë e tyre (shënimet mund të ndryshohen dhe mos të lejné gjurmë). Në përgjithësi këto regjistra janë të mangëta dhe nuk ofrojnë informacione detale mbi pasuritë të tilla si: barkodi, data e pranimit etj;

¹³ "Furnizim me material elektrik dhe vegla pune për shkollat dhe komunën" menaxher i kontratës Drejtori i Arsimit; "Shërbimet e mirëmbajtjes teknike të institucioneve komunale dhe arsimore" menaxher i kontratës ishte Drejtori i Shëndetësisë; dhe "Ndërtimi i kanalizimit në fshatrat Klinë - Kuçicë" " menaxher i kontratës Drejtori i Urbanizmit.

- Në gjashtë raste të testuara, kemi identifikuar se në programin me të cilin menaxhohen pasuritë jo kapitale (blerje të vitit 2016 dhe 2017) nuk ishte kalkuluar zhvlerësimi; dhe
- Komisioni për inventarizim, kishte hartuar raportet individuale lidhur me inventarizimin e pasurisë së komunës, mirëpo nuk kishin hartuar një raport përmbledhës për pasuritë, duke përfshirë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara, përderisa komisioni i vlerësimit nuk kishte hartuar ndonjë raport.

Rreziku

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që e posedon si dhe rezulton në prezantimin jo të drejtë në pasqyra financiare. Mos inventarizimi i plotë i pasurisë, shkakton mangësi në menaxhimin dhe raportimin e saktë të pasurisë, duke rrezikuar njëkohësisht keqpërdorimin apo humbjen e pasurive.

Rekomandimi 14

Kryetari, duhet të siguroj që menaxhimi i pasurisë jo financiare të bëhet në përputhje të plotë me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë. Në këtë aspekt duhet të sigurojë evidentimin e pasurisë jo kapitale si dhe të sigurojë funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve. Me tutje, të sigurojë se pas procesit të inventarizimit gjendja e inventarizuar krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme identifikohen dhe më pas pasqyrohen në regjistrat e pasurive.

3.10 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në PFV në fund të vitit ishin 1,151,000€. Strukturën e të arkëtueshmeve e përbëjnë: tatimi në pronë, taksa në biznes, qiratë dhe lejet e ndërtimit. Pjesëmarrjen më të madhe në këtë strukturë e kanë të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë 736,000€ dhe të arkëtueshmet taksa në biznes 240,000€.

Çështja 15 - Mos veprimet për inkasim të llogarive të arkëtueshme

E gjetura Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve të saj, përfshirë të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, taksat në biznes si dhe të hyrave nga qiradhënia, si:

- Vonesa të konsiderueshme në inkasimin e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë, kryesisht nga viti 2003. Prej tyre një rast kishte të bënte me të arkëtueshmet e AKP-së në vlerë 6,870€ për organizatat shoqërore të përfshira në procesin e privatizimit, si dhe në 25 raste tjera kishte vonesa në pagesa nga qytetarë dhe biznese në vlerë 59,111€ (të arkëtueshme që figuronin nga viti 2003-2016);
- Te taksat në biznes, edhe pse komuna në vitin 2017 kishte marrë vendim për shlyerjen e të arkëtueshmeve deri në vitin 2008 (me kusht pagesa e plotë e obligimeve deri në vitin 2014), ky veprim nuk i ka inkurajuar bizneset që t'i paguajnë obligimet e tyre ndaj komunës. Nga testimi i mostrave është vërejtur se të arkëtueshmet ishin që nga viti 2003; dhe
- Te shfrytëzimi i pronës publike/toka, në tri mostra të testuara (11,763€), të arkëtueshmet figuronin qysh prej vitit 2009. Për më tepër, njëri prej tyre ishte shfrytëzues ilegal i pronës publike¹⁴. Po ashtu, në një rast tjetër, shfrytëzuesi i hapësirës publike/lokal afarist nuk kishte paguar asnjëherë qiranë mujore që nga viti 2015, i cili deri në fund të vitit 2017 kishte borxhin e akumuluar ndaj komunës në vlerë 4,785€.

Komuna nuk ka ndonjë softuer të veçantë për menaxhimin e të hyrave/llogarive të arkëtueshme, përveç taksave në biznes, llogaritë menaxhohen në Excel, të cilat nuk japin siguri të plotë për të dhënat (mund të ndryshohen dhe nuk mbesin gjurmë).

¹⁴ Me rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, nder të tjera parashihet "Që të ngarkohen më pagesë edhe shfrytëzuesit momental ilegal, varësisht sipas kriterëve (çmimeve) të përcaktuara për shfrytëzimin e pronave".

Rreziku Mungesa e veprimeve konkrete për inkasimin e llogarive të arkëtueshme rezulton me rritje të këtyre llogarive, kjo mund të ndikoj që komuna të ketë humbje financiare si dhe rrezikon në mos realizimin e projekteve të komunës. Mungesa e softuerëve funksional, rrezikon saktësinë dhe plotësinë e informatave për të arkëtueshmet dhe shpalosjen e tyre në PFV.

Rekomandimi 15 Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në inkasimin e llogarive të arkëtueshme, duhet të sigurojë procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe inkasimit të tyre. Posedimi i programit efektiv do ta lehtësonte punën dhe mirëmbajtjen e këtyre llogarive.

3.11 Obligimet e papaguara

Detyrimet e papaguara ndaj furnitorëve në pasqyrat financiare ishin 1,174,280€, që krahasuar me vitin 2016 ishin më të larta për 189% më shumë se obligimet e vitit 2016 (405,200€). Komuna, arsyeton këtë si pasojë e mungesës së buxhetit, tejkalimeve të kontratave kornizë dhe arritjes me vonesë të faturave nga OE. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Po ashtu, komuna kishte edhe detyrime kontingjente në vlerë 602,000€.

Çështja 16 - Vonesat në pagesa si dhe dobësitë në raportimin e obligimeve

E gjetura Sipas Rregullës financiare nr.02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, neni 5 pika 3 “Raporti mujor i obligimeve të papaguara”, duhet të përfshijë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur”. Po ashtu, Organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme për pagesë, ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës.

Megjithatë, është vërejtur se:

- Vlera e obligimeve të raportuara për muajin dhjetor në MF ishte 16,393€¹⁵, që tregon se raportimet mujore në thesar paraqiten vetëm si obligime të muajit përkatës duke mos përfshirë totalin e obligimeve të papaguara pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur; dhe
- Në gjashtë mostra të testuara kemi identifikuar vonesa në pagesa nga ana e komunës prej 10 deri në 94 ditë mbi afatin kohor të përcaktuar për pagesë.

E gjetura Kontrollat e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve mujore, paraqesin pasqyrim jo të drejtë të obligimeve, ndërsa vonesat në pagesa krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues.

Rekomandimi 16 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur.

¹⁵ Obligimet në PFV ishin prezantuar në vlerë 1,174,280€, ndërsa në raportin e obligimeve vetëm 16,393, më diferencë 1,157,887€.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 ka rezultuar me 20 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna, mirëpo raporti i ZKA-së si dhe progresi lidhur me zbatimin e planit të veprimit të rekomandimeve të auditimit nuk ishte diskutuar në Asamblenë Komunale.

Deri në fund të auditimit tonë, prej 20 rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit 2016, shtatë rekomandime janë zbatuar; shtatë janë pjesërisht të zbatuara dhe gjashtë nuk janë zbatuar. Ndërsa, katër rekomandime të vitit 2015 edhe më tej mbesin të pa zbatuara (ref: Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme).

Çështja 17 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Edhe pse janë zbatuar kërkesat për të hartuar një plan veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për vitin 2016, raporti i auditimit dhe progresi lidhur me zbatimin e planit të veprimit nuk ishin diskutuar në Asamblenë Komunale. Si rrjedhojë e menaxhimit jo efektiv të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve, vetëm një pjesë e ulët e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar.

Menaxhmenti i komunës nuk aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Përmirësimet e kërkuara të proceseve operationale dhe të tjera mund të mos zbatohen duke rezultuar në mos efikasitet të vazhdueshëm përderisa rekomandimet e dhëna nuk adresohen.

Rekomandimi 17 Kryetari, duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioritetëve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Procesi i dobët për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të vitit paraprak, mungesa e proceseve monitoruese për menaxhimin e rrezikut dhe kontrolle të dobëta mbi shpenzimet dhe të hyrat janë disa nga dobësitë e identifikuara në qeverisje.

Komuna me kohë kishte përmbushë kërkesën për dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit në MF. Njëra nga çështjet e pyetësorit e cila kishte të bënte me proceset efektive të monitorimit lidhur me progresin e objektivave, konsiderohet si e vendosur nga ana e komunës mirëpo, nuk na janë ofruar dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve.

Gjithashtu për vitin 2017, sistemi për menaxhim të rreziqeve ishte vendosur por nuk ishin paraparë veprimet monitoruese për mbikëqyrjen e aktiviteteve për menaxhimin e rreziqeve.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në komunë operon me vetëm një anëtar i cili njëkohësisht është Drejtori i NjAB-së. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë disa auditime për vitin 2017. NjAB ka planifikuar në total pesë auditime, të cilat ishin realizuar në tërësi.

Komiteti i auditimit ishte funksional dhe kishte mbajtur tri takime të rregullta ku janë shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm duke i dhënë mbështetje NjAB-së me zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ana e menaxhmentit.

Çështja 18 - Mos kompletimi i NjAB-së

- E gjetura** Organizatat buxhetore¹⁶ me buxhet më të madh se pesë milionë euro duhet të angazhojnë së paku tre auditorë në NjAB. Për vitin 2018 është bërë kërkesë buxhetore për staf mbështetës.
- Rreziku** Angazhimi i vetëm një auditori në një komunë, mund të ndikoj që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.
- Rekomandimi 18** Kryetari, duhet të rishikoj situatën nëse NjAB ka burime të mjaftueshme njerëzore për të përmbushë në mënyrë të suksesshme detyrat e saj, si dhe të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i NjAB-së të përfshijë më shumë auditime të cilat mbulojnë të gjitha fushat e rëndësishme për komunën.

¹⁶ Sipas udhëzimit administrativ 23/2009

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 19 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Rrjedhimisht pasqyrat financiare vjetore kanë rezultuar me pasaktësi dhe gabime. Trajtimi i disa zërave nuk ka qenë adekuat, si regjistrat e paplota të pasurive, si dhe klasifikimi i shpenzimeve në PFV.

Sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, komuna duhet të ketë një sistem për menaxhim të rreziqeve. Për vitin 2017 ky sistem ishte vendosur por nuk ishin paraparë veprimet monitoruese për mbikëqyrjen e aktiviteteve për menaxhimin e rreziqeve.

Rreziku Kërkesat e llogaridhënies dhe raportimi financiar duhet të forcohen për të përkrahur efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, saldot fillestare duhet të rishikohen dhe verifikohen në mënyrë që informacioni financiar të jetë i krahasueshëm dhe i plotë në funksion të konsistencës dhe mbi të gjitha ta përkrahë vendimmarrjen.

Rekomandimi 19 Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe

gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

të përfshihet menjëherë pas opinionit;

të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;

të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe

të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve për dy vitet paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e Vitit Paraprak	Kryetari i Komunës duhet të rishikoj Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të vitit 2014. Ky plan duhet të përcaktojë një kornizë të arsyeshme kohore të zbatimit, personel përgjegjës dhe modalitet në aplikim, duke u fokusuar fillimisht në fushat e rëndësisë së lartë, dmth. ku janë identifikuar dobësi domethënëse. Progresi i planit duhet të monitorohet direkt nga Kryetari.		Megjithëse komuna disa nga rekomandimet i ka zbatuar, ende nuk ka arritur në tërësi të zbatoj rekomandimin për regjistrim të aseteve dhe menaxhimin e borxhit.	
2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe raportimit të drejtorive komunale për të siguruar aranzhime të përmirësuara, për të arritur objektivat specifike gjatë një viti.		Komuna ka raportime të rregullta, mirëpo ende nuk ka arritur të ketë një raportim adekuat formal, pasi nuk ka procesverbale të shkruara të raportimeve të fusha e pasurisë dhe në disa fusha tjera.	
2.5.3 Raportimi Menaxherial	Kryetari i Komunës duhet të rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimit të brendshëm të komunës. Kërkesat pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2016. Cilësia e raportimit dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të shqyrtohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të komunës.		Cilësia e raportimit në komunë ishte përmirësuar dukshëm, mirëpo mbikëqyrja buxhetore në disa raste kishte qenë e dobët - fusha e pasurive.	

2.6 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Departamenti i Auditimit të Brendshëm ka burime të përshtatshme dhe të mjaftueshme njerëzore. Për më tepër, Kryetari duhet të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i AB duhet të udhëhiqet në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në risk. Gjithashtu, në mënyrë që përfitimet të jenë të dukshme, Kryetari duhet të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të AB brenda Komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të identifikoj shkaqet rrënjësore të mangësive dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar se kërkesat e ligjit te prokurimit janë zbatuar plotësisht.		Janë ndërmarrë masa për përmirësim, mirëpo ende ka raste kur mungon zotimi i mjeteve para lidhjes së kontratave, menaxhimi i kontratave në prokurim ka ende vend për përmirësim.	
3.5.2 Kompenzimet (Pagat dhe Mëditjet)	Kryetari duhet të sigurojë që komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontroleve mbi dosjet e personelit dhe procesit të rekrutimit në mënyrë që dosjet të jenë të kompletuara dhe organizuara mirë si dhe procesi i rekrutimit të jetë në pajtueshmëri me rregulloret përkatëse, dhe të marrë masa në lidhje me nënshkrimin e listës së pagave.		Përmirësime janë bërë në plotësimin e dosjeve, mirëpo ende të gjitha listat e pagave (drejtori të caktuara) nuk nënshkruhen.	
3.6 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)	Përmirësimi i sistemet e faturimit dhe të kontabilitetit në mënyrë që të sigurojë kontrole të sigurta, efieciente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave lidhur me sisteme të tilla do ti mundësonte menaxhmentit të monitoroj dhe të menaxhoj risqet e mëdha, dhe të siguroj që vendimet lidhur me buxhetimin, planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave bëhen në mënyrë të duhur. Gjithashtu të siguroj që verifikimi dhe vlerësimi janë të plota dhe mirë të dokumentuara.		Komuna ka përmirësuar disa segmente të faturimit, ka aplikuar disa kontrole mirëpo ende menaxhimi i të hyrave bëhet në program Excel, për të gjitha të hyrat përveç programit Protax me të cilin menaxhohen të hyrat nga tatimi në pronë.	

3.7 Pasuritë dhe Detyrimet	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive kapitale jo-financiare është kryer në pajtim me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare të Organizatave Buxhetore dhe të siguroj se inventarizimi bëhet në baza vjetore.	Po		
3.7 Pasuritë dhe Detyrimet	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që komuna mban informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me pasuritë jokatitale dhe të siguroj se pasuritë janë zhvlerësuar në bazë të rregullores në fuqi.			Nuk janë marrë masa.
3.7.2 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.		Komuna ka bërë progres në këtë fushë, mirëpo ende nuk është zbatuar ky rekomandim.	
3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se komuna ndërmerr hapa dhe të hartoj një plan të detajuar lidhur më arkëtimin e borxheve të vjetra.			Nuk janë marrë masa.
3.7.4 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm dhe të zhvilloj plane veprimi për të bërë pagesat brenda periudhës së kërkuar.			Nuk janë marrë masa.

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.Pasqyrat financiare vjetore	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i korrigjuar gabimet në kontabilitet për të siguruar regjistrim të saktë të pasurive dhe shpalosje të plotë të llogarive të arkëtueshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		Me gjithë përpjekjet, komuna nuk ka arritë të ketë regjistra të plotë dhe të saktë të pasurive, për këtë çështje edhe është theksuar opinionin e auditimit.	
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate.		Komuna nuk ka arritë të zbatojë shumicën e rekomandimeve të vitit paraprak, në mungesë të monitorimit të progresit të rekomandimeve ende një pjesë e tyre mbetet pa zbatuar.	
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari i komunës duhet hartoj planet operative për zbatimin e strategjive të komunës, si dhe në periudha adekuate të kryej rishikimin për dinamikën dhe përshtatjen e ndryshimeve sipas rrethanave aktuale.			Nuk janë marrë masa.
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se segmentet e potencuara të menaxhimit duhet të rishikohen dhe verifikohen në mënyrë që informacioni financiar të jetë i krahasueshëm dhe i plotë në funksion të konsistencës, dhe mbi të gjitha ta përkrahë vendimmarrjen për përmirësimin e performancës në drejtim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve.		Me gjithë përpjekjet për përmirësim të raportimeve pasqyrat financiare vjetore kanë rezultuar me pasaktësi sa i përket çështjeve të shpalosjeve të pasurive.	

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të rishikoj situatën nëse NJAB ka burime të mjaftueshme njerëzore për të përmbushë në mënyrë të suksesshme detyrat e saj, si dhe të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i AB të përfshijë më shumë auditime të cilat mbulojnë të gjitha fushat e rëndësishme për komunën.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Për të shmangur ndikimet e përmendura më lart, Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit vjetor të pronave dhe të siguroj se verifikimi i pronave komunale bëhet në baza të rregullta vjetore, dhe sipas kuotave të përcaktuara me Udhëzimin administrativ.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se aplikimi i taksës për rritje të densitetit të jetë në harmoni të plotë me aneksin 2 të UA 22/2012 të MMPH-së.	Po		
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet t'i analizoj rastet e përmendura më lart dhe të siguroj dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim të jetë në harmoni të plotë me kërkesat ligjore. Gjithashtu, në të ardhmen, për rastet e tilla duhet të aplikoj ankandet publike si një mekanizëm për trajtim të barabartë të të gjitha palëve të interesuara.	Po		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj që listat e pagave nënshkruhen nga të gjithë të punësuarit e komunës.		Në zbatim, vetëm disa nga drejtoritë nuk e kanë zbatuar këtë rekomandim.	
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari të siguroj se zyrtarët e prokurimit i zbatojnë me konsistencë të gjitha kërkesat e rregulloreve të prokurimit, ndërsa çertifikuesi i pagesave të siguroj se asnjë pagesë nuk ekzekutohet para se të jenë përmbushë të gjitha kushtet ligjore.		Disa procese të prokurimit janë përmirësuar gjatë vitit 2017, mirëpo ne kemi identifikuar pa rregullsi edhe në këtë raport.	

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.	Po		
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari i shpenzimeve e bën klasifikimin e duhur të shpenzimeve sipas planit kontabël dhe shpenzimet regjistrohen nëpër kodet përkatëse.	Po		
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur të gjitha kontrollet e duhura në procesin e ndarjes së subvencioneve dhe se raportet gjatë vlerësimit të aplikuesve në terren dëshmojnë se përfituesit i kanë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara për të cilat është lejuar subvencioni.			Nuk janë marrë masa.
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë hartuar projektet ekzekutive sipas UA i KRPP nr. 1/2014 për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë. Po ashtu, pasi që komuna veç e ka kontraktuar këtë shërbim, të iniciojë me kohë procesin e hartimit të projekteve dhe të aplikoj një koncept më ekonomik të administrimit të përgjithshëm të projekteve.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në të gjitha proceset ku janë identifikuar dështimet, dhe në veçanti, çertifikimi i pagesave nuk duhet të bëhet për asnjë pagesë para se të arrihet siguria se janë përmbushë të gjitha kushtet ligjore që pagesat të procedohen.	Po		
3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pagesat bëhen sipas ndarjeve fillestare të buxhetit dhe sipas kategorive ekonomike të përcaktuara me rregulloret e Thesarit.		Ka progres në raport me vitin paraprak, mirëpo edhe në vitin 2017 kemi identifikuar disa raste kur janë kryer pagesa nga kategoritë ekonomike jo adekuate.	

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj që procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregulloret e Thesarit.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari i Komunës duhet ta shqyrtoj rastin pse falja e borxheve është bërë edhe për kategoritë e borxheve që nuk parashihen me ligj dhe të siguroj procese adekuate për faljen e borxheve. Një nga mënyrat e faljes së këtij lloj borxhi është përmes Kuvendit Komunal. Po ashtu, duhet të siguroj vendosjen e mekanizmave efektiv për mbledhjen e borxheve.		Përkundër përmirësimeve në menaxhimin dhe raportimin e të arkëtueshmeve, ende vlera e tyre është e lartë.	
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur kontrole më efektive, që evidentimi dhe pasqyrimi i saldove të llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë.	Po		
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të shtoj kontrollet dhe të siguroj se të gjitha faturat e pranuar do të evidentohen, kontrollohen, protokollohen dhe paguhen brenda afateve ligjore.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Gradonacelnika / Office of the Mayor

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Skenderaj, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Bekim Jashari


Kryetar i Komunës së Skenderaj,

Data: 11.qershor.2018, Skenderaj,